



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

KRYETARI I KOMUNËS

14-451/02-0234/139/17, më 18.09.2017

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të nenit 17, paragrafi 3 të Ligjit nr. 04/L-179, për transportin rrugor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 21/13, qershor 2013), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për subvencionimin e ndërmarrjes publike lokale “Trafiku Urban” sh.a. Prishtinë.
- II. Shuma e mjeteve financiare për subvencionimin e ndërmarrjes publike lokale “Trafiku Urban” sh.a., nga pika I e këtij vendimi, do të jetë 9,900.00€.
- III. Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, i ndahet ndërmarrjes publike lokale “Trafiku Urban” sh. a., për mbulimin e kostos financiare për transportin e pensionistëve dhe shërbyesve civilë të Komunës së Prishtinës, për muajin Tetor 2017.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- NPL “Trafiku Urban” sh. a.;
- Drejtorisë së Financave;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti